

SHPENZIMI I PARASË PUBLIKE PËRMES PROKURIMIT PUBLIK



SHPENZIMET E PARASË PUBLIKE PËRMES PROKURIMIT PUBLIK

Prishtinë, nëntor 2023

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyre, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres.

Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres - INPO dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Rockefeller Brother Fund.



Përkrahur nga:

Rockefeller Brothers Fund
Philanthropy for an Interdependent World

Përmbajtja

1. Hyrja.....	6
2. Metodologjia.....	7
3. Buxheti i Komunës së Prishtinës dhe Ferizajt për vitet 2022 dhe 2023	8
3.1. Komuna e Prishtinës	8
3.2. Komuna e Ferizajt	8
4. Investimet kapitale.....	9
4.1. Aspekte krahasimore në mes të buxhetit, planit të prokurimit dhe raportit të kontratave të nënshkruara gjatë viteve 2022 dhe 2023.....	10
4.1.1. Komuna e Prishtinës.....	10
4.1.2. Komuna e Ferizajt.....	11
5. Projektet kapitale të buxhetuara por të paplanifikuara	13
5.1. Komuna e Prishtinës.....	13
5.2. Komuna e Ferizajt	14
6. Gjetjet kryesore	18
7. Rekomandimet.....	19

I. Hyrja

Investimet kapitale janë kategoria më e rëndësishme brenda buxhetit të një komune meqenëse kryesisht përmes kësaj kategorie komuna formëson projektet të cilat prekin interesin dhe ndikojnë direkt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të komunës së caktuar.

Qëllimi i kësaj analize është vlerësimi planifikimit dhe ndarjes së buxhetit për investime kapitale nga ana e komunës së Prishtinës dhe Ferizajt. Analiza tenton të jap përgjigje pyetjeve se si komunat planifikojnë projektet kapitale përmes buxhetit, sa dhe si reflektohet ky planifikim në planifikimin përfundimtarë të prokurimit si dhe sa nga projektet e planifikuara, implementohen përmes kontratave të prokurimit brenda vitit fiskal që është planifikuar.

Pjesa e parë e analizës paraqet aspektet se si Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Ferizajt e kanë të ndarë buxhetin për vitin 2022 dhe 2023 sipas 5 kategorive buxhetore, duke pasqyruar kështu në shifra totale secilën kategori. Analiza vazhdon me aspekte krahasimore për secilën nga dy komunat e fokusit, duke pasqyruar kështu numrin e projekteve kapitale të parapara me buxhetin e vitit 2022 dhe 2023, numrin e projekteve kapitale të planifikuara me planet përfundimtare të prokurimit për vitet fiskale përkatëse dhe numrin e kontratave të nënshkruar për projekte kapitale për vitin 2022 dhe për gjashtëmujorin e vitit 2023.

Tutje, analiza bënë krahasime edhe në mes të vlerës totale të projekteve kapitale të parapara me buxhet të komunave dhe vlerën totale të projekteve kapitale të parapara me planet përfundimtare të prokurimit, ku vërehet një dallueshmëri shumë e madhe.

Në fund, trajtohen projektet kapitale të cilat kanë qenë të buxhetuara, mirëpo të njëjtat nuk kanë mundur të hasen në planet përfundimtare të komunave, duke dëshmuar kështu që komunat nuk arrijnë që të planifikojnë në mënyrë efikase dhe efektive shpenzimet për projektet kapitale.

2. Metodologjia

Gjatë hartimit të kësaj analize me theks të veçantë është aplikuar metoda e analizës dhe ajo krahasimore. Kjo analizë përfshinë Komunën e Prishtinës dhe Ferizajt dhe të dhënat janë për vitin 2022 dhe gjashtë mujorin e parë të vitit 2023.

Fillimisht në ueb faqet e komunave janë siguruar dokumentet e nevojshme për analizë, ndërsa dokumentet e munguara janë siguruar nëpërmjet kërkesave për qasje në dokumente publike. Fillimisht janë analizuar qarkoret buxhetore për vitet 2022 dhe 2023 si dhe buxhetet e votuara nga komunat për të parë saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave.

Pas kësaj, për secilën komunë është evidentuar numri i projekteve kapitale për vitin përkatës së bashku me vlerën totale të tyre, pastaj numri i projekteve kapitale të parapara me plan përfundimtar të prokurimit si dhe numri i kontratave për projekte kapitale të nënshkruara gjatë vitit përkatës. Analiza dhe krahasimi i të dhënave përfshinë periudhën janar-dhjetor 2022 dhe Janar-Qershor. Krahasimi në mes të projekteve të planifikuara dhe atyre të nënshkruara gjatë periudhës janar – qershor 2023, është bërë duke konsideruar vetëm numrin e projekteve që sipas planit përfundimtar të prokurimit janë planifikuar të të iniciohen para datës 30 qershor 2023.

Në fund, projektet kapitale të buxhetuara janë verifikuar veç e veç, se të njëjtit a mund të identifikohen në planet e prokurimit të komunave përkatëse, dhe ato që nuk ka qenë e mundur të verifikohen janë vendosur në tabela së bashku me vlerën e tyre të paraparë me buxhet.

3. Buxheti i Komunës së Prishtinës dhe Ferizajt për vitet 2022 dhe 2023

Buxheti i komunave është një pasqyrë sistemike e të hyrave dhe shpenzimeve brenda vitit të caktuar fiskal. Nëpërmjet të hyrave buxhetore komunat arrijnë të funksionojnë normalisht dhe të përmbushin objektivat e tyre institucionale duke ofruar shërbime të mira dhe të ligjshme për qytetarë. Buxheti i komunave përbëhet nga 5 kategori, përkatësisht: (i) paga dhe mëditje, (ii) mallra dhe shërbime, (iii) shpenzime komunale, (iv) subvencione dhe (v) transfere dhe shpenzime kapitale.

3.1. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës është Kryeqytet i Republikës së Kosovës dhe sipas këtij statusi gëzon benefite shtesë që burojnë nga Ligji për Kryeqytetin.¹ Kësisoj Prishtina ka një buxhet mjaft të lartë, krahasuar me komunat tjera, pavarësisht (pa) mjaftueshmërisë në raport me kërkesat dhe nevojat, të cilat nuk trajtohen në këtë raport.

Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe 2023				
2022				
Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale
31,300,000.00€	21,198,930.00€	2,200,000.00€	4,786,215.00€	31,184,188.00€
2023				
Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale
32,470,000.00€	25,000,000.00€	2,700,000.00€	5,150,000.00€	40,355,981.00€

Tabela 1: Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2022 dhe 2023.²

Buxheti i Komunës së Prishtinës për vitin 2023 është rritur për 16.55 % në tërësi, ndërsa vetëm për investime kapitale për vitin 2023 buxheti është 29.41% më i lartë se sa viti paraprak. Rrjedhimisht, vërehet qartë se rritja më e lartë i është dedikuar kategorisë së investimeve kapitale.

3.2. Komuna e Ferizajt

Gjithashtu edhe kjo komunë ka një buxhet të konsiderueshëm vjetor, me çka një pjesë mjaftë e lartë e buxhetit shkon për investime dhe projekte që direkt ndikojnë në jetën e qytetarëve. Në vazhdim edhe për Komunën e Ferizajt është paraqitur buxheti për vitin 2022 dhe 2023 i ndarë në 5 kategori.

¹ Shih nenin 19 të Ligjit Nr. 06/L-012 për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16506>.

² **Burimi:** Buxheti i aprovuar nga Komuna e Prishtinës, i qasshëm në: <https://prishtinaonline.com/investimet/buxheti>

Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2022 dhe 2023				
2022				
Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale
15,960,525.00€	5,529,067.00€	725,686.00€	963,776.00€	10,754,814.00€
2023				
Paga dhe mëditje	Mallra dhe shërbime	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transfere	Shpenzime kapitale
16,331,588.00€	7,507,500.00€	950,000.00€	1,200,000.00€	12,114,664.00€

Tabela 2: Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2022 dhe 2023.³

Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2023 është rritur për 12.28 %, ndërsa vetëm për investime kapitale për vitin 2023 buxheti është 12.64% më i lartë se sa viti paraprak, e cila rritje është pothuajse identike me rritjen e përgjithshme të buxhetit. Ndërsa sa u përket kategorive buxhetore, për dallim nga Komuna e Prishtinës, Komuna e Ferizajt, rritjen më të lartë e ka për kategorinë mallra dhe shërbime, me 35.78%.

4. Investimet kapitale

Prej 5 kategorive buxhetore, kategoria e investimeve kapitale është më e rëndësishmja. Kjo për faktin se buxheti i ndarë për këtë kategori shkon në projekte investuese, të cilat në mënyrë direkte ndikojnë në jetën e qytetarëve. Janë pikërisht projektet kapitale përmes se cilave mundësohet zhvillimi ekonomik.

Përderisa kategoritë tjera buxhetore, përjashtuar kategorinë e subvencioneve, shkojnë kryesisht për mirëmbajtjen e funksioneve të institucionit të komunës, praktikisht janë para konsumuese të padukshme, investimet kapitale janë kryesisht projekte të prekshme të cilat qytetarët mund t'i shohin, t'i shfrytëzojnë dhe të njëjtat ndikojnë direkt në rritjen edhe të kualitetit të jetës së qytetarëve të komunës së caktuar.

Komunat në çdo vit fiskal, ndajnë një vlerë të konsiderueshme të buxhetit për investime kapitale, rrjedhimisht thënë komunat për afërsisht 40% të buxhetit e ndajnë për projekte, apo investime kapitale. Inicim dhe zhvillimi i projekteve kapitale, përkatësisht kontraktimi i projekteve kapitale detyrimisht shkon nëpërmjet procedurave të prokurimit publik.

Në këtë drejtim, përveç buxhetimit të projekteve kapitale, nga komunat kërkohet që të kenë edhe një planifikim të mirë të këtyre projekteve. Se a janë planifikuar mirë projektet e buxhetuara, kjo mund të vërtetohet nga analizimi i planeve përfundimtare të prokurimeve të komunave⁴, se a

⁴ Shih Formularin B01, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>

realizohen në masën e duhur projektet kapitale kjo mund të shihet nëpërmjet raportit të kontratave të nënshkruara nga komunat.⁵


4.1. Aspekte krahasimore në mes të buxhetit, planit të prokurimit dhe raportit të kontratave të nënshkruara gjatë viteve 2022 dhe 2023

Komunat gjatë hartimit të buxhetit për vitin e ardhëm fiskal, përveçse planifikimit të tërësishëm buxhetorë në 5 kategori, gjithashtu janë të obliguar që të listojnë ndër tjerash edhe projektet kapitale, duke listuar secilin projekt veç e veç, duke vendosur edhe vlerën e buxhetit të ndarë për vitin përkatës fiskal, por edhe parashikimet për dy vitet e ardhme.

Për qëllime të analizës janë bërë krahasime në mes të numrit projekteve kapitale të buxhetuara në buxhetin e vitit 2022 dhe 2023, numrin e projekteve kapitale të planifikuara me plan të prokurimit dhe numrin e kontratave lidhur me projekte kapitale të nënshkruara gjatë vitit përkatës.

4.1.1. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës për projekte kapitale ka ndarë një shumë të konsiderueshme të buxhetit, dhe një numër të konsiderueshëm të projekteve kapitale. Të dhënat lidhur me numrin e projekteve kapitale të parapara me buxhet, me plan të prokurimit dhe numrin e kontratave të nënshkruara lidhur me projekte kapitale i gjeni në grafikonin në vazhdim.



Grafikoni I: Aspekt krahasimor në numra në mes të buxhetit, planit të prokurimit, dhe kontratave të nënshkruara për projekte kapitale.

Të dhënat në grafikonin I tregojnë se Komuna e Prishtinës për vitin 2022 në buxhet ka planifikuar dhe ka ndarë buxhet për gjithsej 109 projekte kapitale, ndërsa në plan të prokurimit ka paraparë

⁵ Shih Formularin B53, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>

gjithsej 95 kontrata. Gjatë po të njëjtit vit, bazuar në raportin e kontratave publike të nënshkruar për vitin 2022, rezulton se kjo komunë ka nënshkruar gjithsej 96 kontrata për projekte kapitale.

Në buxhetin për vitin 2023 janë paraparë gjithsej 114 projekte kapitale, ndërsa në plan të prokurimit janë paraparë gjithsej 123 projekte kapitale, 122 prej të cilëve është planifikuar të inician në pjesën e parë të vitit 2023, përkatësisht deri më 30 qershor. Ndërsa, ashtu siç mund të shihet edhe në grafikun, në gjashtëmuorin e parë të viti 2023 janë nënshkruar gjithsej 45 kontrata për projekte kapitale.

Shqetësues mbetet fakti se Komuna e Prishtinës nuk ka planifikuar me plan përfundimtar të prokurimit të gjitha projektet ashtu siç janë buxhetuar. Përderisa në vitin 2022 në plan të prokurimit parashihen më pak projekte sesa janë paraparë në buxhet, në vitin 2023 në plan të prokurimit numri i projekteve kapitale në plan të prokurimit është më i lartë se numri i projekteve të tilla në buxhetin e vitit 2023. Gjithashtu, në vitin 2022, edhe pse në grafikun figuron se numri i projekteve të planifikuara është tejkaluar, në fakt nëse merret buxheti i planifikuar dhe vlera e parashikuar e kontratave të nënshkruara gjatë vitit 2022 ka një dallim të madh.

Përderisa 95 projektet kapitale të planifikuara me plan të prokurimit kanë vlerë totale të parashikuar 29,403,444 euro, vlera e parashikuar e 96 kontratave të nënshkruara është vetëm 18,040,882.60 euro. Kjo është një tregues i qartë i asaj se Komuna e Prishtinës nuk respekton as planin e prokurimit kur inicon aktivitetet të prokurimit.

Përveç kësaj, ekziston një dallim mjaftë i lartë në mes të buxhetit të dedikuar për projekte kapitale i cili figuron në buxhetin e Komunës së Prishtinës dhe vlera e parashikuar e projekteve të parapara me plan përfundimtar të prokurimit. Këto të dhëna krahasimore i gjeni në tabelën në vazhdim.

Dallimi në mes të buxhetit të ndarë për projekte kapitale dhe buxhetit që figuron për këto projekte në planin përfundimtar të prokurimit			
2022		2023	
Buxheti	Plani i prokurimit	Buxheti	Plani i prokurimit
31,184,188.00 €	29,403,444.00 €	40,355,981.00 €	88,363,986.60 €
Diferenca	-1,780,744 € (-5.71%)	Diferenca	+48,008,005.60 € (+118.9%)


Tabela 3: Dallimi në mes të buxhetit të ndarë për projekte kapitale dhe buxhetit që figuron për këto projekte në planin përfundimtar të prokurimit.

Ashtu siç shihet edhe në tabelë, Komuna e Prishtinës përveç nga numri i projekteve, ka një dallim esencial edhe në mes të vlerës totale të buxhetit të dedikuar për projekte kapitale dhe vlerës së parashikuar të projekteve kapitale të parapara me plan përfundimtar të prokurimit. Përderisa në vitin 2022 vlera totale e projekteve kapitale të parapara me plan të prokurimit është 1,780,744 euro apo 5.71% më pak sesa buxheti i dedikuar për këtë kategori, në vitin 2023 ndodh e kundërta, ku me plan të prokurimit vlera e projekteve kapitale shkon në 48,008,005.60 euro, apo 118.9% më shumë sesa buxheti i dedikuar për projekte kapitale për këtë vit.

4.1.2. Komuna e Ferizajt

Të dhënat e analizës për Ferizajn tregojnë se ka mospërputhje në mes të asaj që buxhetohet, planifikohet dhe kontraktohet për projekte kapitale. Në grafikun në vazhdim janë paraqitur

detaje lidhur me numrin e projekteve kapitale të buxhetuara për vitin 2022 dhe 2023, numrin e projekteve kapitale të planifikuara me planin përfundimtar të prokurimit për vitin e caktuar fiskal dhe numrin e kontratave për projekte kapitale të nënshkuara në vitet përkatëse.



Grafikoni 2: Aspekt krahasimor në numra në mes të buxhetit, planit të prokurimit, dhe kontratave të nënshkuara për projekte kapitale.

Ashtu siç mund të shihet edhe në grafikonin 2, numri i projekteve kapitale të buxhetuara është shumë më i lartë se numri i projekteve kapitale të parapara me planin përfundimtar të prokurimit, ndërsa numri i kontratave të nënshkuara për projekte kapitale është pakrahasimisht më i vogël se dy të parat. Si në vitin 2022, po ashtu edhe në 2023, rezultatet e të dhënave në Komunën e Ferizajt tregojnë nivel të përafërt prej vitit në vit, në mes të asaj që buxhetohet, planifikohet dhe nënshkruhet.

Konkretisht në buxhetin për vitin 2023 në buxhet janë paraparë gjithsej 110 projekte kapitale, ndërsa në plan të prokurimit janë paraparë vetëm 51 projekte kapitale, 48 prej të cilëve është planifikuar të iniciohen në pjesën e parë të vitit 2023, përkatësisht deri më 30 qershor, ndërsa brenda këtij gjashtë mujori janë nënshkruar gjithsej 11 kontrata për projekte kapitale. Sa i përket vitit 2022, me buxhet janë paraparë gjithsej 139 projekte kapitale, me plan të prokurimit janë paraparë vetëm 89, ndërsa gjatë tërë vitit 2022 janë nënshkruar vetëm 33 kontrata për projekte kapitale.

Pra, në të dy vitet numri i projekteve kapitale të parapara me buxhet është dukshëm më i lartë sesa numri i projekteve kapitale të parapara me plan përfundimtar të prokurimit, po ashtu në të dy vitet numri i kontratave të nënshkuara është shumë më i vogël sesa numri i projekteve të planifikuara dhe buxhetuara.

Gjithashtu, edhe tek Komuna e Ferizajt ekziston një dallim mjaftë i lartë në mes të buxhetit të dedikuar për projekte kapitale i cili figuron në buxhet dhe vlerës së parashikuar të projekteve kapitale të parapara me plan përfundimtar të prokurimit. Këto të dhëna krahasimore i gjeni në tabelën në vazhdim.

Dallimi në mes të buxhetit të ndarë për projekte kapitale dhe buxhetit që figuron për këto projekte në planin përfundimtar të prokurimit			
2022		2023	
Buxheti	Plani i prokurimit	Buxheti	Plani i prokurimit
10,754,814.00€	16,281,191.00€	12,114,664.00€	18,543,509.00€
Diferenca	+5,526,377€ (+51.38%)	Diferenca	+6,428,845€ (+53.06%)

Tabela 4: Dallimi në mes të buxhetit të ndarë për projekte kapitale dhe buxhetit që figuron për këto projekte në planin përfundimtar të prokurimit.

Të dhënat dëshmojnë se edhe Komuna e Ferizajt planifikimin e prokurimit nuk e ka të bazuar në buxhetin e saj. Në vitin 2022 të dhënat tregojnë se planifikimi për projekte kapitale ka qenë më i lartë se buxheti për 5,526,377 euro, apo 51.38%, ndërsa në vitin 2023 për 6,428,845 euro, apo 53.06%.

5. Projektet kapitale të buxhetuara por të paplanifikuara

Për iniciimin dhe implementimin e secilit projekt kapital është e rëndësishme që komuna të ketë në dispozicion buxhet të caktuar. Pra, nuk mund të iniciohet, e as të planifikohet prokurimi për projektin kapital pa ekzistimin e buxhetit të caktuar. Shumën e buxhetit për investime kapitale të komunave e saktëson qarkorja buxhetore e cila nxirret çdo vit nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.⁶ Në momentin që komunat pranojnë qarkoren në fjalë, e kanë të qartë se sa është buxheti i tyre për projekte kapitale dhe në përputhje me atë vlerë totale, të njëjtat përpilojnë planet e tyre për projekte kapitale, duke listuar secilin projekt veç e veç dhe duke ia saktësuar edhe vlerën buxhetore. I njëjti buxhet pasi të votohet në kuvendet komunale të komunave merr versionin përfundimtar dhe mbi bazën e atij buxheti dhe projekteve të listuara në të, komunat pritet që ta hartojnë edhe planin e prokurimit për vitin e ardhshëm fiskal.

Me të parë dallueshmëri të numrave në mes të projekteve kapitale të buxhetuara dhe projekteve kapitale të planifikuara, ka qenë e domosdoshme që të analizohet ajo se sa nga projektet e buxhetuara për vitin përkatës nuk mund të identifikohen në planin përfundimtar të prokurimit.

5.1. Komuna e Prishtinës

Nga analizimi i asaj se a mund të identifikohen projektet kapitale të buxhetuara në planin e prokurimit të vitit përkatës, del që një numër i konsiderueshëm i tyre nuk mund të identifikohen. Në Komunën e Prishtinës sa i përket vitit 2022 është një numër mjaft i madh i projekteve të cilat figurojnë në buxhet por jo edhe në plan të prokurimit, ndërsa në vitin 2023 ky numër është

⁶ Për më shumë shih qarkoret buxhetore, të qasshme në <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,31>.

dukshëm më i vogël. Në tabelat në vazhdim mund t'i gjeni projektet e buxhetuara në vitin 2022 dhe 2023 të cilët nuk kanë mundur të identifikohen në planin përfundimtar të prokurimit.

Projektet që janë në buxhet por jo në plan të prokurimit viti 2022		
Nr.	Titulli	Vlera në € për 2022
1.	Mirëmbajtja e objektit të vjetër të Komunës, BL-ve dhe objekteve tjera komunale.	80,000.00
2.	Digjitalizimi i shërbimeve në sportele.	50,000.00
3.	Ndërrimi i tubacionit, enës ekspanduese, valvulave dhe radiatorëve të ngrohjes qendrore - kontratë kornizë.	130,000.00
4.	Rregullimi dhe riparimi i ashensorëve.	200,000.00
5.	Trajtimi i mbeturinave ndërtimore.	100,000.00
6.	Projekti i kogjenerimit NQ "Termokos".	1,000,000.00
7.	Marrëveshja me MCM për matësa për ngrohje.	1,000,000.00
8.	Rregullimi i pompave për furnizim me ujë për ndërtesat kolektive dhe mirëmbajtja.	70,000.00
9.	Furnizimi me fidanë për hapësirat e qytetit dhe parqet (Pyllëzimi urban).	200,000.00
10.	Furnizimi me lule dekorative shumëvjeçare.	20,000.00
11.	Renovimi artistik i Tunelit të Kurrizit (FAZA 2).	100,000.00
12.	Renovimi i Amfiteatrit të Qytetit.	80,000.00
13.	Figurat socio-kulturore të qytetit të Prishtinës.	70,000.00
14.	Masat e EE-Efiqencës dhe energjisë për ndërtesë të banimit në bashkëpronësi.	100,000.00
15.	Rregullimi dhe renovimi i amfiteatrit në Pishinën e Gërmisë.	150,000.00
16.	Mekanizim bujqësor.	100,000.00
Total:	16 projekte	3,450,000.00
Projektet që janë në buxhet por jo në plan të prokurimit viti 2023		
Nr.	Titulli	Vlera në € për 2023
1.	Instalim dhe mirembajtje e rampave.	50,000.00
2.	Rekonstruimi dhe renovimi i gropave në komunën e Prishtinës.	500,000.00
Total:	2 projekte	550,000.00

Tabela 5: Projektet që janë në buxhet por jo në plan të prokurimit viti 2022 dhe 2023.

Ashtu siç mund të shihet edhe në tabelën numër 5, Komuna e Prishtinës gjatë vitit 2022 nuk ka arritur që 16 projekte kapitale në vlerë 3,450,000 euro t'i parasheh me planin përfundimtar të prokurimit, përkatësisht të njëjtat nuk ka qenë e mundur të identifikohen në planin e prokurimit. Ndërsa në vitin 2023 kjo situatë ndryshon për të mirë, ku vetëm 2 projekte kapitale të parapara në buxhet, në vlerë totale 550,000 euro nuk mund të identifikohen në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2023.

5.2. Komuna e Ferizajt

Në krahasimin e numrit të projekteve kapitale të buxhetuara dhe atyre të planifikuara me planin përfundimtar të prokurimit, Komuna e Ferizajt e ka një dallueshmëri mjaftë të lartë. Kjo dallueshmëri është reflektuar edhe në atë se një numër shumë i lartë i projekteve kapitale të buxhetuara nuk kanë mundur të identifikohen në planin përfundimtar të prokurimit. Në tabelën në vazhdim është paraqitur secili projekt që nuk ka mundur të identifikohet në plan të prokurimit.

Projektet që janë në buxhet por jo në plan të prokurimit viti 2022		
Nr.	Titulli	Vlera në € për 2022
1.	Rregullimi i sallës së kuvendit të Komunës	18,439.71
2.	Shtruarja e rrugëve me zhavorr – hapja e rrugëve të reja	150,000.00
3.	Riparimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik	250,000.00
4.	Rregullimi i infrastrukturës për persona me aftësi të kufizuar	20,000.00
5.	Ndërtimi i objektit të pastërtisë	90,000.00
6.	Masat e efikasitetit të energjisë në ndërtesat publike	10,000.00
7.	Rikonstruimi i rrjetit të ndriçimit publik	250,000.00
8.	Asfaltimi me katër korsitë të rrugës Cen Dugolli dhe Reçaku nga policia deri te Driton Islami	70,000.00
9.	Kolektori Verior i kanalizimit fekal prej fshatit Talinoc deri në Rahovicë	150,000.00
10.	Zgjerimi i rrugës Rexhep Bislimi, prej rrethit deri tek kisha	40,000.00
11.	Ndërtimi i kolektorit veri-perëndimor	105,000.00
12.	Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugës kryesore në fshatin Rakaj	150,000.00
13.	Asfaltimi i rrugëve në Mirash	80,000.00
14.	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dardani, dhe Mirosalë dhe trotuarit në Fshatin e Vjetër	150,000.00
15.	Asfaltimi i rrugës Zaskok – Ferizaj	100,000.00
16.	Asfaltimi i rrugës Gjergj Fishta	30,000.00
17.	Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugës Agim Ramadani	132,709.48
18.	Ndërtimi i mureve mbrojtëse në Greme, Gaçkë, Mirosal	50,000.00
19.	Ndërtimi i stacionit të autobusëve faza I	100,000.00
20.	Asfaltimi i rrugës kryesore dhe trotuarit në lagjen Tafaliaj në Komogllavë	100,000.00
21.	Realizimi i kyçjeve të ujësjellësit për Neredime dhe Manastirc	50,000.00
22.	Rregullimi i parkut në Prelez, të Muhaxherëve dhe ndërtimi i fushës sportive në Surqinë, Tërë, Mirash	50,000.00
23.	Hapja e puseve të ujit të pijshëm në Kosonë dhe rregullimi i rrjetit të kanalizimit Kosonë-Dremjak	60,000.00
24.	Ndërtimi i infrastrukturës për mbrojtjen e kulturave bujqësore	80,000.00
25.	Ndërtimi i tregut të kafshëve dhe ndërtimi i strehimores së qenve	60,000.00
26.	Rregullimi i rrugëve të arave me zhavorr	200,000.00
27.	Vendosja e tabelave për emërtim të rrugëve dhe numrave të shtëpive	30,000.00
28.	Ndërtimi i parqeve të reja	100,000.00
29.	Rrënimet e objekteve pa leje	20,000.00
30.	Ndërtimi i sallës sportive në Fshatin e Vjetër	100,000.00
31.	Ndërtimi i shkollës së re në Neredime	60,000.00
Total	31 projekte	2,856,149.19
Projektet që janë në buxhet por jo në plan të prokurimit viti 2023		
Nr.	Titulli	Vlera në € për 2023
1.	Ndërtimi i objektit të ri të Komunës së Ferizajt në bashkëfinansim me donatorë dhe ndërtimi i Arkives së Komunës së Ferizajt	30,000.00
2.	Shtruarja e rrugëve me zhavorr -hapja e rrugëve të reja	300,000.00
3.	Hapja e puseve në prona publike	30,000.00
4.	Asfaltimi i rrugës "Gjergj Fishta" deri te rruga "Enver Topalli" dhe lidhja me rrugën " Ejup Statovci"	30,000.00
5.	Zgjerimi i rrugës Rexhep Bislimi prej rrethit deri te kisha	50,000.00
6.	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Neredime e Eperme	100,000.00

7.	Kolektori verior i kanalizimit fekal prej fshatit Talinoc i Muhaxhereve deri në Rahovicë	100,000.00
8.	Ndërtimi i trotuarit nga fshati Balaj deri në Jezerc dhe rregullimi i shtratit të lumit Nerodime	50,000.00
9.	Ndërtimi i trotuarit në rrugën kryesore të fshatit dhe rrugëve të mbetura në fshatin Komogllavë	80,000.00
10.	Asfaltimi i rrugicave në Bablak dhe rrugicave të mbetura në fsh. Tern dhe Prelez i Jerlive	80,000.00
11.	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Balaj	90,000.00
12.	Asfaltimi i rrugës Zaskok Ferizaj	50,000.00
13.	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Mirash	40,000.00
14.	Asfaltimi i rrugëve në lagjet ku mungon në fshatin Koshare, Slivovë, Lloshkobare, Kosinë dhe shpërndarja e gypit të ujësjellësit në fsh.Koshare	50,000.00
15.	Ndërtimi i Stacionit të ri të Autobusëve në Ferizaj	200,000.00
16.	Ndërtimi i kompleksit të varrezave të reja të Qytetit	150,000.00
17.	Ujësjellësi Greme –Dremjak	50,000.00
18.	Asfaltimi i rrugës kryesore në fshatin Rakaj	50,000.00
19.	Asfaltimi i rrugëve në fshatin Dremjak	50,000.00
20.	Asfaltimi i rrugës që lidh lagjen Omuraj me lagjen Spahiaj në Greme dhe rrugëve të mbetura në fshatin Greme	100,000.00
21.	Asfaltimi dhe zgjerimi i rrugës Agim Ramadani në zonën rekreative-sportive	30,000.00
22.	Asfaltimi i rrugës kryesore dhe trotuarit në lagjen Tafalijaj, Komogllavë	50,000.00
23.	Asfaltimi me katër korsi i rrugës Cen Dugolli dhe Reçakut nga Policia deri te rr.Driton Islami	60,000.00
24.	Rregullimi i trotuarit në rrugën kryesore në fshatin Mirosalë dhe rrugëve Dardani	50,000.00
25.	Asfaltimi i rrugëve me trotuar në Cërnille dhe Surqinë	100,000.00
26.	Rregullimi i kyqjeve të ujësjellësit në Neredime dhe Manastirc	50,000.00
27.	Ndërtimi i trotuarit në fshatin Doganaj	70,000.00
28.	Asfaltimi i rrugës kryesore në fsh Surqinë, rrugëve dhe trotuarit në Prelez të J. dhe rrugëve në Muhoc	50,000.00
29.	Asfaltimi i rrugëve dhe rregullimi i trotuarëve në fshatrat Varosh, Fshat i Vjetër, Bibaj dhe Nilkadin	50,000.00
30.	Asfaltimi i rrugës Gaçke Topojan Gerlice dhe Gaçke e Eperme Bajram Curri dhe rregullimi i ujësjellësit në Gaçke dhe B.Curri	50,000.00
31.	Rregullimi i parkut në Prelez të Muhaxherve dhe ndërtimi i fushës sportive në Surqinë dhe Terrn	30,000.00
32.	Rikonstruimi i rrugës "Ahmet Kaçiku"	160,000.00
33.	Rregullimi i rrjetit të kanalizimit në rrugën Sadik Bega	50,000.00
34.	Rregullimi i kanalizimit fekal dhe i rrugëve në lagjen Mehaj, fshati Dremjak	50,000.00
35.	Asfaltimi i rrugëve në Softaj - lagja Raqe dhe ndërtimi i mureve mbrojtëse në lagjen Kamenica	70,000.00
36.	Ndërtimi i rrugës Varosh Gerlicë përgjatë hekurudhës dhe ndërtimi i mbikalimeve për këmbësorë	70,000.00
37.	Rregullimi i trotuarit, asfaltimi i rrugëve në fsh. Sojevë dhe rrugëve të mbetura në fsh. Zllatar, rregullimi i shtegut dhe trotuarit në rrugën Shaban dhe Rashit Topalli	115,000.00
38.	Rregullimi i rrjetit të dëmtuar të kanalizimit në fshatrat Greme dhe Mirosalë	100,000.00
39.	Funksionalizimi i rrjetit të ujësjellësit në Greme dhe Ferizaj dhe shpimi i puseve në Komogllavë dhe Dremjak	50,000.00
40.	Rikonstruimi i rrugës kryesore në fshatin Varosh	50,000.00

41.	Hapja e puseve te ujit te pijshëm në Kosinë dhe rregullimi i rrjetet të ujësjellësit Kosinë Dremjak	100,000.00
42.	Rregullimi i kanalizimit në rrugën Naim Frasheri	30,000.00
43.	Rikonstruimi i rrugës kryesore në Prelez të Jerlive	30,000.00
44.	Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe dislokimi i gypit të ujësjellësit në fshatin Surqinë	50,000.00
45.	Rregullimi i Tregut të Kafsheve dhe ndërtimi i Strehimores së qenve	250,000.00
46.	Shtuarja e rrugëve të arave me zhavor në Koshare, Greme, Rahovicë etj	310,432.00
47.	Ndërtimi i parqeve të reja, Krijimi i hapësirave të gjelbërta(mbjellja e drunjëve dekorativ	200,000.00
48.	Rregullimi i tregut të gjelbër	50,000.00
49.	Ndërtimi i aneksit të qendrës rezidenciale	70,000.00
50.	Rregullimi i oborrit të qendrës rezidenciale	120,000.00
51.	Ndërtimi i palestrës sportive në fshatin Balaj	40,000.00
52.	Ndërtimi i fushave të ping pongut dhe tabelave të shahut në Ferizaj	20,000.00
53.	Ndërtimi i fushave sportive në Ferizaj dhe fshatrat Lloshkobare, Pleshinë, Prelez i Muhaxherëve	30,000.00
54.	Ndërtimi i shkollës së mesme në Ferizaj	200,000.00
55.	Ndërtimi i sallës sportive në Fshatin e Vjetër	100,000.00
56.	Ndërtimi i shkollës së re "Konstandin Kristoforidhi" në Neredime	100,000.00
57.	Ndërtimi i aneksit të shkollës fillore-Ish Shaban Hashani në Ferizaj	191,042.51
58.	Ndërtimi i shkollës fillore në fsh.Tërrn	100,000.00
59.	Ndërtimi i sallës së sporteve në shkollën Astrit Bytyqi në Ferizaj	100,000.00
Total	59 projekte	5,796,474.51

Tabela 6: Projektet që janë në buxhet por jo në plan të prokurimit viti 2022 dhe 2023.

Komuna e Ferizajt si në vitin 2022, ashtu edhe në vitin 2023 nuk ka paraparë në planin përfundimtar të prokurimit një numër të konsiderueshme të projekteve kapitale të parapara me buxhetin e vitit përkatës. Përderisa në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2022 nuk mund të identifikohen 31 projekte kapitale në vlerë totale 2,856,149.19 euro, në vitin 2023 ky numër dyfishohet duke shkuar në gjithsej 59 projekte kapitale të cilat nuk mund të identifikohen në planin përfundimtar të prokurimit, në vlerë totale 5,796,474.51 euro.

Këto shifra, si për Komunën e Ferizajt, ashtu edhe për atë të Prishtinës janë shumë shqetësuese dhe tregojnë shumë për atë se si komunitat planifikojnë buxhetin për projekte të caktuara. Përkatësisht këto të dhëna janë tregues i qartë që komunitat nuk arrijnë të planifikojnë në mënyrë profesionale buxhetin dhe planin e prokurimit për projekte kapitale, dhe për pasojë shumë projekte mbesin të pazbatuara duke u përsëritur dhe bartur nga buxheti në buxhet si dhe shumë projekte inicoohen pa qenë fare të planifikuar.

6. Gjetjet kryesore

- Komuna e Prishtinës dhe Ferizajt pothuajse 40% të buxhetit vjetor e kanë të dedikuar për investime kapitale.
- Projektet kapitale të Komunës së Prishtinës dhe Ferizajt të buxhetuara dhe të planifikuara me plan të prokurimit dallojnë shumë, si për nga numri, ashtu edhe për nga vlera.
- Asnjëra nga komunat e monitoruara nuk kanë arritur që të realizojnë të gjitha projektet e buxhetuara dhe të planifikuara.
- Komunat nuk arrijnë që t'i planifikojnë me plan të prokurimit të gjitha projektet e buxhetuara, për pasojë një numër i konsideruar i tyre mbesin jashtë planifikimit të komunave.

7. Rekomandimet

- Komuna e Prishtinës dhe Ferizajt të kujdesen që buxhetin e dedikuar për projekte kapitale ta planifikojnë dhe shpenzojnë në bazë të ligjit dhe në mënyrë profesionale.
- Komuna e Prishtinës dhe Ferizajt të kujdesen projektet kapitale të buxhetuara si për nga numri, ashtu edhe për nga vlera të përputhen edhe me planin e prokurimit.
- Komuna e Prishtinës dhe Ferizajt të sigurohen se projektet kapitale të buxhetuara dhe planifikuara të gjejnë zbatim, sepse janë të një rëndësisë shumë të madhe për qytetarët.
- Komuna e Prishtinës dhe Ferizajt të kujdesen se të gjitha projektet kapitale të buxhetuara ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore t'i vendosin edhe në plan përfundimtar të prokurimit.



Iniciativa për Progres (INPO) është organizatë joqeveritare dhe jofitimprurëse e themeluar ne vitin 2005 me qëllim që të përparoj pjesëmarrjen e qytetarëve në proceset shoqërore, përmes së cilës pjesëmarrje avokohet për çështje sociale, politike, ekonomike, forcimin e parimit të transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve publike, rritjen e kërkesave të qytetarëve si dhe luftimin e korrupsionit, duke synuar në promovimin e vlerave të një shoqërie të hapur dhe demokratike.

Vizioni dhe misioni i organizatës përmbushet përmes aktiviteteve të ndryshme të punës të cilat organizohen nga dy (2) programet e specializuara të organizatës: 1. Qeverisja e Mirë dhe 2. Edukimi Demokratik.

 **+383 (0) 49 354 000**

 **info@inpo-ks.org**

 **www.inpo-ks.org**

